

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                         |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | BIRN: Institucionet e drejtësisë kundërshtojnë projektligjin për pagat e magistratëve                                                                                                                                                   |
| ADRESA  | <a href="https://piranjat.al/politike/birn-institucionet-e-drejtësisë-kundërshtojnë-projektligjin-per-pagat-e-i104492">https://piranjat.al/politike/birn-institucionet-e-drejtësisë-kundërshtojnë-projektligjin-per-pagat-e-i104492</a> |
| BURIMI  | piranjat.al                                                                                                                                                                                                                             |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                  |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 16 shtator 2026, 16:17:40 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 16:08:28 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 65f8504f01b879a7a697fdf17383f7ad58d75449e42a379d154f0356b842fa11 |
| TEKSTI     | ec59981c81e35954f12331c2ceac8865bef452fc771906a7e90ac2ca1892cef7 |
| PAMJA      | 5b3aefd9356bcb6e1727c36d09a683bc9427201a58cfbdbc2717c7beffdfb7d9 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | e506e514e05851facec0cabe4dfc7ff1ffb48e4429d3af8bc638a879331bd998                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 6d78d2dc60f31cde5fa6ff278c9155b75ea76fff53014b2b93764708aa00c94f                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e506e514e05851facec0cabe4dfc7ff1ffb48e4429d3af8bc638a879331bd998>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash: pas dënimit të për misione të posaçme, Richard Grenell, reagoi ■ norvegjezit vazhdojnë të qarkullojnë, ndërsa protestuesit këtu herë ■ edhe Olta Xhaçkën: O Ballën, protestuesit këtu herë ■ që dënoi me 81 vjet gjykues në çështjen ■ Hagës: Një ditë ndaj katër drejtuesve të UÇK-së.

POLITIKE

## BIRN: Institucionet e drejtësisë kundërshtojnë projektligjin për pagat e magjistratëve

Piranjat Përditësimi i fundit 16 Shtator 2026, 18:08



Gjykata e Lartë dhe Prokuroria e Përgjithshme kundërshtuan të mërkurën më 16 shtator projektligjin e ri për pagat e magjistratëve, duke vlerësuar se formula e propozuar nuk respekton standardet e përcaktuara nga Kushtetuta dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese të muajit shkurt, që shfuqizoi formulën e mëparshme.

Projektligji pritet të votohet në seancën plenare të Kuvendit të entjen më 17 shtator, pasi u miratua në komisionet parlamentare me votat e deputetëve socialistë. Ai parashikon një formulë përlogaritëse me rritje prej 2% të pagës referuese – ndjeshëm më e ulët se përlogaritja e bërë më parë nga organet qeverisëse të sistemit të drejtësisë mbi bazën e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata e Lartë reagoi me tone të ashpra jo vetëm ndaj përbajtjes së projektligjit, por edhe ndaj mënyrës se si ishte zhvilluar konsultimi parlamentar.

“Gjykata e Lartë shpreh kundërshtimin e saj më të fortë ndaj mënyrës se si Komisioni për Çështjet Ligjore zhvilloi procedurën parlamentare për projektligjin që prek drejtpërdrejt pagat, statusin dhe garancitë kushtetuese të magjistratëve. Ajo që ndodhi nuk ishte thjesht një konsultim i mangët. Ishte një shpërfillje e hapur e kuptimit të konsultimit institucional dhe e përfaqësuesve të një pushteti kushtetues, të thirrur nga vetë Kuvendi për t’u dëgjuar”, thuhet në deklaratë.

Gjykata kujtoi se ky nuk ishte reagimi i parë i gjyqësorit për çështjen e pagave, duke iu referuar qëndrimit të saj publik të 2 shtatorit.

Sipas deklaratës, përfaqësuesit e gjyqësorit u njoftuan më pak se dy orë përpara se të paraqiteshin në Komisionin për Çështjet Ligjore dhe u dëgjuan pa iu vënë në dispozicion të gjitha amendamentet që ndryshonin projektligjin për të cilin ishin thirrur të jepnin mendim.

“Pa informacion të plotë mbi opinionin financiar të Qeverisë dhe pa mundësinë për të dhënë qëndrim mbi tekstin që realisht po merrte formë për votim. Nuk mund të thërrasësh një pushtet kushtetues për konsultim dhe në të njëjtën kohë, t’i mbash të panjohura elementet mbi të cilat do të marrësh vendimin. Kjo cenon seriozitetin dhe integritetin e vetë procedurës parlamentare”, theksoi Gjykata e Lartë, duke e cilësuar të papranueshme mënyrën se si ishin trajtuar përfaqësuesit e gjyqësorit.

Gjykata ngriti gjithashtu shqetësimin se dëgjesa parlamentare nuk solli reflektim të dukshëm mbi argumentet e paraqitura nga gjyqësori dhe grupet e interesit për mospërputhjen e projektligjit me standardet kushtetuese.

“Gjyqësori nuk mund të thirret në Kuvend vetëm për të plotësuar formalisht një procedurë. Gjyqësori nuk mund t’i kërkohet mendim për një tekst, të mos reflektohet mbi argumentet e tij dhe më pas të procedohet mbi një tekst të ndryshuar pa i dhënë mundësinë të shprehet për të”, thuhet në deklaratë.

Në reagimin e saj, Gjykata e Lartë solli gjithashtu në vëmendje kontrastin mes respektit institucional që, sipas saj, i tregohet drejtësisë shqiptare në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe trajtimit të saj brenda vendit. Si shembull u përmend pritja e drejtuesve të institucioneve të drejtësisë në Romë nga Presidenti i Republikës Italiane, Sergio Mattarella, në kuadër të organizimit në Tiranë të Kongresit Botëror për Ligjin 2027.

Por shqetësimin kryesor Gjykata e Lartë e lidhi me mënyrën se si projektligji trajton vendimin nr. 15 të Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar se formula e re nuk reflekton arsyetimin detyrues të tij.

“Gjykata Kushtetuese ka folur qartë. Ajo ka përcaktuar kufijtë kushtetues brenda të cilëve ligjvënësi mund të ndërhyjë në pagën e magjistratit dhe pasojat që lidhen me shfuqizimin e formulës së mëparshme. Ligjvënësi ka të drejtën të gjejë zgjidhjen normative, por jo të sillt sikur vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk ekziston”, thuhet në deklaratë.

Sipas Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk respektohen vetëm duke iu referuar atyre, por duke zbatuar përbajtjen dhe arsyetimin kushtetues që ato imponojnë.

Gjykata evidentoi gjithashtu se ndërhyrja e ligjvënësit erdhi pasi gjyqësori kundërshtoi publikisht bllokimin e pagave dhe kërkoi zbatimin e vendimit të Kushtetueses. Sipas saj, mënyra e ndërhyrjes, pa transparencë të plotë dhe konsultim real, ngre pikëpyetje mbi karakterin penalizues të projektligjit.

“Gjyqësori nuk pranon arrogancën e askujt që ushtron pushtetin sikur ai të ishte i pakufizuar dhe i pakontrollueshëm. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka pushtet mbi Kushtetutën dhe nuk ka neshat të nënshtruar nga kufijtë dhe kontrolli kushtetues. Gjykata e Lartë nuk kërkon asnjëherë ndaj Kuvendit, por nuk pranon as nënshkrimin e gjyqësorit ndaj tij. Ndërsa e kushtetuese nuk nish

hierarki ndërmjet tyre. Një kompetenca, kufij dhe kontroll kushtetues”, theksohet në deklaratë.

Në përfundim, Gjykata e Lartë i kërkoi Kuvendit që të mos e kalojë për shqyrtim dhe miratim në seancën e së enjtes projektligjin në formën aktuale.

“Kuvendi miraton ligje, por nuk mund të relativizojë Kushtetutën. Mund të zgjedhë zgjidhjen ligjore, por nuk mund të anashkalojë një vendim përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese. Mund të ftojë gjyqësorin për konsultim, por nuk mund ta përdorë praninë e tij për të legjitimuar një konsultim që realisht nuk ka ndodhur”, thuhet në deklaratë.

Edhe Prokuroria e Përgjithshme njoftoi të mërkurën se i kishte përcjellë Kuvendit qëndrimin e saj kundër projektligjit. Sipas institucionit, formula e propozuar nuk garanton zbatimin e plotë dhe efektiv të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe standardeve kushtetuese të përcaktuara prej tij.

“Ky projektligj krijon diferenca të pajustificuara dhe jo harmonike mes niveleve të ndryshme të gjykatave dhe prokurorive”, citohet në njoftimin e Prokurorisë së Përgjithshme.

**Përplasja për formulën e pagave**

Gjykata Kushtetuese shfuqizoi në shkurt të këtij viti si të papajtueshme me Kushtetutën formulën e mëparshme të miratuar nga Kuvendi për pagat e magjistratëve dhe i la ligjvënësit afat deri më 31 korrik për miratimin e një formule të re.

Vendimi parashikonte gjithashtu një mekanizëm zhblokues, sipas të cilit formula e re e pagave do të përcaktohej nga vetë organet qeverisëse të sistemit të drejtësisë në rast se Kuvendi nuk vepronte brenda afatit.

Pas përfundimit të afatit, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë përcaktuan një pagë bazë referuese prej 222 mijë lekësh dhe 14 mijë lekë shtesë për kualifikimin. Këshillat vendosën gjithashtu kompensimin e asaj që e konsideruan “ulje të fshehur” të pagave nga ligji i mëparshëm, për periudhën nga prilli 2023 deri më 31 korrik 2026.

Ministria e Financave refuzoi ta zbatonte këtë përllogaritje, ndërsa magjistratët iu drejtuan SPAK me kallëzim penal dhe Gjykatës Administrative me padi. Gjykata Administrative vendosi në favor të pagesës së gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas formulës së përcaktuar nga këshillat.

Përplasja mes institucioneve të drejtësisë dhe shumicës parlamentare pritet tashmë të zhvendoset në seancën plenare të së enjtes, ku projektligji është parashikuar për votim./BIRN/

**Artikuj te sugjeruar**

POLITIKE 16 Shtator17:56

**"Zgjohet" Lulzim Basha dhe reagon për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së**

Nga Lulzim Basha Vendimi i gjykatës speciale është një goditje për të gjithë shqiptarët. Dënimet e shqiptuara ndaj...

POLITIKE 16 Shtator16:36

**PD ripërsërit kërkesën: Kuvendi të miratojë rezolutën për dënimin e gjenocidit serb në Kosovë**

Partia Demokratike ka ripërsëritur kërkesën që Kuvendi i Shqipërisë të miratojë një rezolutë për d...

POLITIKE 16 Shtator15:59

**Nesër shpallet vendimi për Ilir Metën, ish presidenti: Nuk kam munguar asnjëherë në gjyq**

Është mbajtur seanca në Gjykatën e Apelit të Posaçëm, me relatore gjyqtaren e posaçme Saida Dollani, një proces...

POLITIKE 16 Shtator15:49

**Vendimi i Hagës/ Berisha: Thirrja jonë është për vetëpërmbytje! Emocionet nuk duhet të ndikojnë në stabilitetin e Kosovës**

Partia Demokratike reagoi kundër vendimit të Gjykatës së Hagës dhe dënimit të ish-drejtesve të UÇK. Në mble...

POLITIKE 16 Shtator15:30

**Pas Ballukut dhe Ballës, protestuesit kapin “mat” në rrugë edhe Olta Xhaçkën: O hajdute...**

Pasi kanë kapur mat në rrugët e Tiranës Belinda Ballukun dhe Taulant Ballën, protestuesit këtë herë janë për...

POLITIKE 16 Shtator14:22

**"I ka çmendur hajnia"/ Denoncon Berisha: Aeroportin e Vlorës do ia japin Yeffetit! Agasi ka hequr 4 ministra dhe...**

Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka hedhur akuza të forta ndaj qeverisë gjatë mbledhjes së grupit parlamentar të PD-sëe...

POLITIKE 16 Shtator13:52

**"Festë në Serbi! U shqyrtuan dosjet e Beogradit"/ Berisha: Ditë e rëndë për shqiptarët, vendimi i Hagës nuk mund ta errësojë luftën e UÇK-së**

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, e ka nisur mbledhjen e grupit parlamentar duke komentuar aktgjykimin e Gjykatës Speciale në Hagëe...

POLITIKE 16 Shtator11:55

**Gjykata e Hagës dënoi ish-krerët e UÇK-së, reagon Rama: Marre!**

Pasi Gjykata e Hagës dënoi me burg ish-krerët e UÇK-së, ka reaguar kryeministri Edi Rama. Përmes një reagimi në rrj...

POLITIKE 16 Shtator09:47

**OCCRP: ‘Revolucioni i Flamingove’ përbën një kërcënim të drejtpërdrejtë për Edi Ramën**

Protestat e shkaktuara nga një resort luksoz i diskutueshëm hyjnë në muajin e tyre të katërt, duke u përshkallëzuar n&...

POLITIKE 16 Shtator08:16

### [Rama drejt SHBA-ve, zbardhen detaje nga agjenda e udhëtimit](#)

Pas vizitës së kryedemokratit Sali Berisha, edhe kryeministri Edi Rama do të udhëtojë drejt Shteteve të Bashkuara të Amerik...

## ME TE VIZITUARAT

BOTA 15 Shtator

### [Takimi pikant zgjat shumë dhe përfundon si mos ...](#)

Një takim seksual tepër i gjatë, një vjedhje parash, një debat midis një eskorte dhe klientit të saj, dhe në fund një&eum...

AKTUALITET 16 Shtator

### [Pagat ndryshojnë strukturë/ Gati gjysma e të pu...](#)

Një e katërta e të punësuarve që derdhin kontributin e parë me pagë deri në 50 mijë lekë në muaj, nd&eu...

KOSOVA 16 Shtator

### [Dënohet me 25 vite burg Hashim Thaçi](#)


Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është shpallur fajtor për krime lufte dhe është dënuar me 25 vjet burgim nga...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


### [Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...


## video



Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV





**Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.